



Pranuar / Dorezuar Prijmenj / Prodato Received / Delivery	03 - 08	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDMSTEK	54.97/2023		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1029/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malshe Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Kaltrina Avdullahi Prenaj, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1029/2023 të datës 26.07.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë: Rr [redacted] Komuna e Prishtinës, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1029/2023 e datës 26.07.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted].

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 03.12.2014 në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsionor në pozitën e punës „Specialist i cilësisë së ajrit” në Departamentin për Institutin Hidrometeorologjik i Kosovës, më datë 26.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5359/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër veprimit administrativ të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me kategorizimin e pozitës së tij në Kategorinë Profesionale 2 me koeficient pesë pikë një (5.1).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsionorë,

ndërsa Këshilli me datë 01.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e palejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht me Akt Emërimin e datës 03.12.2014 rezulton se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në pozitën e punës „*Specialist i cilësisë së ajrit*” në Departamentin e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës me koeficient shtatë (7) sipas sistemit të vjetër të pagave.

Ankuesi, me datë 26.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5359/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/ Ministria e Punëve të Brendshme, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, e ka kategorizuar ankuesin në kategorinë „*Profesionale 2,*” ndërsa i njëjti ka kërkuar ndryshimin nga kategoria aktuale në kategorinë „*Specialistë*”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Institucioni përkatësisht, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, më datë 05.05.2023 ka dërguar kërkesën me numër Nr.2392/23 për korigjimin e gabimeve të ekuivalencës së pagave që lidhet edhe me pretendimin ankimor të ankuesit, ndërsa Kolegji i Këshillit pas administrimit të shkresave të lëndës nuk ka gjetur asnjë një shkresë konkretisht përgjigje nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë-MPB që ka vendosur në lidhje me këtë çështje konkrete, kurse ankuesi ankesën në Këshill e ka parashtruar më datë 24.07.2023, ende pa marrë ndonjë përgjigje zyrtare nga DMZP-ja.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *“1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”,* dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të

vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjëshit deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë „Profesionale 2” është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se Vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konflikt administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1029/2023

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

